

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR "RITUAL SMOKE" shpk,

Në Tiranë, sot më datë 04.03.2024, unë i poshtëshënuari;

Artan Tuzi, i datëlindjes 23.05.1972, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ,H30523102B, me cilësinë e "ortakut themelues" deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, "RITUAL SMOKE" shpk.

## **Neni 1. Emri, Forma**

Shoqëria do të ketë emrin "RITUAL SMOKE shpk", dhe formë ligjore: "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" e quajtur më poshtë "Shoqëria".

## **Neni 2 Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

## **Neni 3 Selia**


Shoqëria "RITUAL SMOKE" shpk e ka selinë në adresë: Tregu Agro Park Farke, rruga e fushave, Godina A, Dyqani A8, Tiranë dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve


## **Neni 4 Objekti i veprimtarisë**

Objekti i ushtrimit të veprimtarisë për shoqërinë "RITUAL SMOKE" shpk është: Import eksport, tregti me shumice e pakice të artikujve të ndryshëm, purove, duhanit dhe aksesoreve të tyre, prodhim filtri duhani, prodhim tub filtri, projektim dhe zbatim të ndertimit të objekteve të ndryshme, transport të mallrave brenda dhe jashtë vendit, si dhe çdo aktivitet tjetër ndihmes apo plotësues që ka lidhje me objektin si me sipër.

## **Neni 5 Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Megji Tuzi  




## Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote te cilat zotërohet si më poshtë:

Artan Tuzi, i datëlindjes 23.05.1972, lindur ne Tiranë dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti, me numër personal ,H30523102B, zotëron një kuotë ose 100 % të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

## Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.


Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".


Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e

Megi Zuri  






- pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### **Neni 9 Administrimi**

Administrator i shoqërisë **“RITUAL SMOKE” shpk** është: Megi Tuzi e datelindjes 23.11.1999 Identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti me numër personal ,J96123041A. Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit të tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 04.03.2024. Afati i emerimit të administratorit është deri me 04.03.2029.

### **Neni 10 Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


### **Neni 11 Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare **“RITUAL SMOKE” shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

#### **ORTAKET THEMELUES**

**Artan Tuzi**



Tiranë, më datë 04.03.2024

Megi Tuzi

